



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 57.
Prishtinë, më 21.12.2012 në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues i OSB-së Elita Vokshi, përfaqësuese i Sekretariatit të KKK Zijush Ahmeti, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tisma, zyrtarë e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, me raportin e komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-159 për zonat ekonomike me raportin e komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – rendi i ditës u miratua pa vërejtje

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 7.12.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente;

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-159 për zonat ekonomike me raportin e komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-159 për zonat ekonomike, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligji nr. 04/L-159 për zonat ekonomike dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme.

Kryesuesi, me theks të veçantë tha se në këtë periudhë Komisioni ka dhënë kontribut të rëndësishëm në procesin e implementimit të ligjeve të cilat ishin në interes në respektimin e të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve.

Ai i njoftoi dhe njëherit ftoi anëtarët e komisionit, të marrin pjesë në drekë solemne për fund vit, e cila do të mbahet me datën 24.12.2012, në Restorant Ultra, Prishtë.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinković